

EC Ma Ndryshe, Fondacioni për Trashëgimi Kulturore, Forumi për Trashëgimi Kulturore, Academy for Training and Technical Assistance, N'GO, Instituti Demokratik i Kosovës – dega në Prizren, GreenArt, X40, EUIRC, Ura e Artit, Durmish Asllano, ICEC, Old timer Club Prizren, Shoqata e Bjeshkatarëve Sharri, Art Plus, Lëvizja për Përparimin e Turizmit, Femra Vizionare

28 janar 2012, Prishtinë

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Protesta qytetare e 29 janarit në Prizren me moton “NUK E DUAM LIGJIN”

Koalicioni ad-hoc i OJQ-ve në Mbrojtje të Qendrës Historike të Prizrenit, në konferencën për media të mbajtur sot ka prezantuar detajet e protestës qytetare për të kundërshtuar projekt-ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit.

Protesta do të mbahet më 29 janar, ditë e diel, me fillim në orën 13.00, ndërsa pikë tubimi do të jetë Sheshi Shadërvan në Prizren. Gjatë protestës do të mbahen tri fjalime, i pari nga organizatorët e protestës, ndërsa dy fjalime të tjera nga Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut dhe Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës. Pas përfundimit të fjalimeve, protestuesit do të ftohen për të qëndruar edhe 15 minuta në heshtje, si shenjë proteste dhe mospajtimi me projekt-ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit. Ndërsa porosia e heshtjes do të jetë se këto janë 15 minutat e fundit të heshtjes së qytetarëve të Prizrenit dhe nëse nuk respektohet vullneti i tyre, atëherë do të pasojë mosbindja qytetare dhe format e tjera të refuzimit qytetar ndaj efekteve të këtij ligji.

Në konferencën e fundit para protestës, organizatorët kanë listuar edhe përkrahjet publike që kanë ardhur ditëve të fundit. Protestën qytetare të 29 janarit, publikisht e kanë përprahur: Lidhja Demokratike e Kosovës (dega Prizren), Lidhja Demokratike e Dardanisë (dega Prizren), Lëvizja për Bashkim, Pardia e Drejtësisë (dega Prizren), Bashkimi Demokratik, Lëvizja Vetëvendosje, Partia Demokratike Turke (dega Prizren), Balli Kombëtar, Bashkësia Islame e Kosovës (Prizren), Teqeja e Saraçhanës (Prizren), Organizata e Veteranëve të Luftës (dega Prizren), Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, AEGEE Prishtina (asociacioni i studentëve evropian), komuniteti afarist i Prizrenit dhe shumë OJQ individualisht nga Kosova dhe Shqipëria.

Në të njëjtën kohë, organizatorët kanë shprehur kundërshtimin e tyre ndaj tendencave të subjekteve të caktuara politike për të përfituar nga ky organizim dhe për t'i dhënë dimensione partiake protestës. Edhe një herë është potencuar se protesta e 29 janarit është protestë qytetare e organizuar nga shoqëria civile, gjatë së cilës, qytetarët pa marrë parasysh bindjet dhe orientimet e tyre politike, fetare, apo etnike do të protestojnë të bashkuar nën moton “Nuk e duam ligjin”. Nuk e duam ligjin sepse Kosova posedon me legjislacion të avancuar dhe institucione adekuate për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, derisa mangësia kryesore është mos-respektimi dhe mos-zbatimi i ligjit. Nëse nuk respektohen ligjet ekzistuese për trashëgiminë kulturore, çka na garanton që një ligj i ri do të respektohet?! Kjo është vetëm edhe një dëshmi që ligji për Qendrën Historike të Prizrenit nuk e ka për qëllim mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, por krijimin e situatave të reja favorizuese për një bashkësi të caktuar fetare, që paraqet diskriminim të qartë të qytetarëve të Prizrenit.

Gjatë konferencës për shtyp Koalicioni i OJQ-ve të Prizrenit ka përsëritur edhe një herë argumentet e shumta që dëshmojnë se projekt-ligji për Qendrën Historike të Prizrenit është anti-kushtetues, diskriminues, ngulfatës për zhvillimin dhe se ai nxit konflikte mbi baza fetare dhe etnike.

Koalicioni i OJQ-ve të Prizrenit i ka ftuar të gjithë qytetarët e Prizrenit, pa marrë parasysh orientimet e tyre politike, fetare ose etnike, që të dielën të jenë të bashkuar në protestën qytetare për të kundërshtuar një ligj që do t'i dëmtojë interesat e të gjithë atyre që jetojnë në Prizrenit.

Koalicioni i OJQ-ve në Mbrojtje të Qendrës Historike të Prizrenit